

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Pejës z. Ali Berisha**

I nderuari z. Berisha,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ndërtimin e ujësjellësit dhe rrugën në Kelmend;
- Për fshatrat Arbanë, Rohotit dhe Radavc: rrugë të asfaltuara, shkolla të reja, kanalizim dhe ujësjellës;
- Për Lugun e Baranit: Asfaltimin e rrugëve; furnizimin me ujë të pijshëm për të gjitha familjet; dhe investime në bujqësi;
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve te secilit fshat të Rugovës;
- Zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit;
- Furnizimin e banorëve të Raushiqit me ujë të pijshëm që në 2010 dhe asfaltimin e rrugëve të këtij fshati më së largu në vitin 2011;
- Angazhim për një administratë edhe më efikase;
- Rregullimin e rrugës Malaj-Pepaj;
- Asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe furnizimin me ujë të të gjitha shtëpive;
- Ndërtimin e kanalizimeve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës;
- Krijimin e kushteve të përshtatshme për bizneset që të punësojnë sa më shumë qytetarë të komunës;
- Investime kapitale nga buxheti vetjak dhe po aq nga investitorë të jashtëm, në vlerë prej 30 milionë euro;
- Punësimin e 3500 qytetarëve në projekte që do të jenë investime të përbashkëta, me investitorët të vendit dhe ndërkombëtarë;
- Hartimin dhe aprovimin e planeve rregullative të Zatrës , Kapeshnicës dhe Qendrës;
- Përcaktimin e planit detal urbanistik;
- Zgjidhjen e problemit të Lumbardhit si dhe e ujërave të zeza dhe mbeturinave;
- Ndërtimin e impianti për ujërat e zeza në negociim me Komisionin Evropian në vlerë prej 15 milionë euro;
- Reduktimin e prerjeve të pyjeve dhe të shfrytëzimit të zhavorrit ,
- Rregullimin e stadiumit të qytetit në bashkëpunim publiko-privat;
- Brenda dy vjetësh nuk do të ketë asnjë rrugë të paasfaltuar dhe asnjë fshat pa ujë;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)